



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 303/6 prot.

Tiranë, më 12.7.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Bashaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.6.2023, është njoftuar vendimi nr. 671, datë 14.6.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.6.2023, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, datë 30.6.2023, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*) nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ylli Bashaj*”² ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë **.10.2017³, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj*”, raport i deklasifikuar plotësisht, pas kërkesës së Komisionit për përditësim dhe deklasifikim informacioni.

2.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁴ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Ylli Bashaj.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** [...] *Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklarim dhe balanca negative e fondeve në vlerën 133,220.34 lekë (ose 1,274,340.3 lekë, nëse në analizën financiare do të konsiderohej si çmim i blerjes së apartamenti vlera 36,000 USD), e përqendruar në një vit të vetëm për blerjen e një pasurie të vetme, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka*

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë **.5.2018.

³ Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së. nr.**, datë **.1.2021.

⁴ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë **.4.2022.

një karrierë më shumë se 30-vjeçare si prokuror, nuk është e mjaftueshme që të pasjellë aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlera e bilancit negativ zë një peshë krahasimisht të vogël në raport me vlerën e blerjes së pasurive objekt kontrolli, si dhe nga analiza financiare e kryer për çdo vit, subjekti rezulton me balanca pozitive të të ardhurave dhe shpenzimeve në një shumë totale prej 10.739.146 lekësh, për pasojë kjo vlerë negative nuk duhet të ndikojë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit.

Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël dhe mungesës së pasojave, nuk cenohet figura e prokurorit dhe as besimi i publikut te drejtësia. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 [...].

3.2 Për kontrollin e figurës. [...] *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] *Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit [...].*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Ylli Bashaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁵ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁶ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 30.6.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr. 303/2 prot., aktin: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. ONM, në konkluzion të këtij rekomandimi, në mënyrë të përmbledhur, referon se konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit është rezultat i një hetimi jokohorent dhe të paplotë të kryer nga Komisioni në vlerësimin e kriterit pasuror dhe shkon kundër parimeve të përcaktuara nga neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Provat e përdorura nga Komisioni, për të

⁵ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁶ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

arritur në konkluzionin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, janë larg të qenët të besueshme ose në pajtueshmëri me provat e tjera të mbledhura gjatë hetimit administrativ. Në përfundim, ONM-ja rekomandon ankimin e vendimit të Komisionit, lidhur me të gjitha rezultatet e dala nga vlerësimi i kriterit të pasurisë, duke përfshirë të gjitha çështjet e tjera të nevojshme.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, në konsideratë të faktit se Kolegji ka juridiksionin e posaçëm dhe të vetëm për të përcaktuar kualifikimet ligjore për çështjet që i përkasin procesit të rivlerësimit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 671/2023 të Komisionit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A Kontrolli i pasurisë

12. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë

bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

13. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ushtron detyrën e prokurorit prej vitit 1992, ka plotësuar deklaratën e interesave privatë për herë të parë në vitin 2003, dorëzuar në ILDKPKI, datë **.5.2004, si dhe në vijim deklaratat periodike vjetore për vitet 2005 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën **.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet se:

14. Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, ndër të tjera, kanë deklaruar pasuritë si vijon: [...] *Apartament⁷ me sip. 93.09 m², blerë me kontratën e shitjes nr. ***/**, datë **.12.2000, për vlerën 28.000 USD. Vlera e asetit 28.000 USD, e shlyer tërësisht. Burimi:*

(1) *10.000 dollarë, kursime nga të ardhurat;*

(2) *10.000 dollarë, marrë kredi në formën e borxhit, nga të afërmit dhe miqtë dhe*

(3) *10.000 dollarë, marrë kredi nga Banka **, sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë **.02.2001 [...].*

14.1 Në DV-2003, dorëzuar në ILDKPKI, datë 10.5.2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Apartament në qytetin e Tiranës, 2+1, vlera 28.000 dollarë, sip. 93 m², rr. “***” nr. **. Blerë privatisht nga “***” sh.p.k. Burimi i krijimit deklarohet:*

(1) *13.000 USD (dollarë amerikanë) kursime;*

(2) *2.000 USD (dollarë amerikanë) **,**, vëllai;*

(3) *2.000 USD (dollarë amerikanë) **,**, djali i xhaxhait;*

(4) *1.500 USD (dollarë amerikanë) **,**, Tiranë;*

(5) *1.500 USD (dollarë amerikanë) **,**, Vlorë;*

(6) *10.000 dollarë, Banka ** në vitin 2001.*

14.2 *Lidhur me deklarinimin e çmimin e blerjes së kësaj pasurie, nga aktet e administruara⁸ në dosje gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, ka rezultuar si vijon:*

14.2.1 Me kontratë shitje nr. ***/**, datë **.12.2000, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., apartament me sipërfaqe 93,09 m², regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. **, datë **.10.2000, ndodhur në rr. “***”, Tiranë, me çmim shitblerje 28.000 USD.⁹

⁷ Subjekti ka depozituar: (i) Certifikatë për Vërtetim Pronësie; (ii) Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. ** rep., nr. ** kol, dt. **.12.2000. (iii) Kontratë Financimi nr. ** rep., nr. ** kol, dt. **.2.2001, midis Bankës ** dhe Ylli Bashaj.

⁸ Shkresë nr. ** prot., datë **.12.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; Shkresë “kthim përgjigje” ASHK Tirana veri, nr. ** prot., datë **.12.2020; Shkresë nr. ** prot., datë **.11.2022, drejtuar shoqërisë “***” sh.p.k.; Shkresë “kthim përgjigje” “***” sh.p.k., nr. ** prot., datë **.12.2022.

⁹ Subjekti i rivlerësimit është pajisur me certifikatë pronësie datë **.12.2018 për këtë pasuri të regjistruar me nr. **, zonë kadastrale **, me sipërfaqe totale 87.09 m². Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI, rezulton se, fillimisht, ai është pajisur me Certifikatë pronësie dt. **.12.2016, e cila përmban të dhëna jo të sakta të atësisë dhe mbiemrit

Në përmbajtje të kontratës së shitblerjes *palët deklarojnë se shuma 28,000 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale, pa pretendime nga palët, si dhe në gjendjen dhe në kushtet që ajo ndodhet.*

14.2.2 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament në muajin mars të vitit 2000. Në përgjigje të pyetjes së Komisionit, në pyetësorin e datës 31.10.2022, i pyetur në lidhje me aktin ligjor përmes së cilit ai ka banuar në këtë apartament nga muaj mars, duke konsideruar që kontrata e shitjes është lidhur në muajin dhjetor të vitit 2000, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *[...] nuk ka pasur një akt të tillë specifik. Apartamenti im është ndërtuar me herët se apartamentet e tjerë të objektit të banimit, pasi për përfundimin e punimeve të brendshme të tij, jam interesuar për realizimin e tyre sa më shpejt, pasi jetoja në një ambient të papërshtatshëm ... nuk mbaj mend të kem lidhur ndonjë kontratë sipërmarrje me përfaqësuesin e firmës së ndërtimit, të objektit... Thjesht ka qenë një marrëveshje verbale me administratorin, të cilit i kam garantuar gjithashtu se do të beja pagesën e plotë, për shlyerjen e vlerës së blerjes të apartamentit, qoftë edhe përmes aplikimit për të përfutur kredi bankare [...].*

14.2.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 31.10.2022, ka bashkëlidhur Vërtetimin nr. ** prot., datë **11.2022, të shoqërisë “****” sh.p.k., nënshkruar nga administratori ***,***, e cila, në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, si person i interesuar, ndër të tjera, referon se: *[...] z. Ylli ***. Bashaj, më datë **12.2000, ka lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., një kontratë shitje me nr. *** rep./*** kol., me objekt blerjen e një apartamenti me sip. 93,09 m², me adresë *** në pallatin **-kate, Bashkia Tiranë. Për apartamentin e sipërcituar, blerësi, z. Ylli Basha, ka paguar në favor të shoqërisë “****”sh.p.k., vlerën totale 28.000 \$, nga të cilat 20.000 \$ janë paguar nëpërmjet arkës së shoqërisë dhe pjesa tjetër prej 8.000 \$ është paguar me bankë [...].*

14.2.4 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij janë financuar nga Banka *** (aktualisht *** Bank), me kontratën e kredisë bankare nr. **/**, datë **.2.2001, për shumën 8.000 USD, me afat 48-mujor, me qëllim financimi “*blerje apartamenti*”. Kjo kredi rezulton të jetë disbursuar në llogarinë e subjektit në datën **.2.2001 dhe po në këtë datë është transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin: “***** për pagesën e këstit të fundit, për blerjen e apartamentit*”, rreth dy muaj më vonë se data e përcaktuar në kontratën e shitjes.

14.2.5 Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë “****” sh.p.k, në lidhje me marrëdhënien e shitblerjes së realizuar me subjektin e rivlerësimit. Shoqëria “****” sh.p.k.¹⁰, në përgjigje të kërkesës së Komisionit,¹¹ datë **12.2022, ndër të tjera, ndryshe, nga sa ka konfirmuar për subjektin në vërtetimin e datës **.11.2022, është përgjigjur se: *[...] Blerësi Ylli Basha, me anë të kontratës së shitjes që disponojmë, me datë **12.2000, me nr. *** rep./*** kol., ka blerë*

të tij (Ylli *** Basha) dhe më tej me urdhër të brendshëm është kryer saktësimi i të dhënave dhe lëshimi i certifikatës së saktë të pronësisë, datë **.12.2018.

¹⁰ Po nënshkruar nga administratori *** **.

¹¹ Në përgjigjen e saj, shoqëria ka vënë në dispozicion të Komisionit: (i) kopje të kontratës së shitblerjes së lidhur me subjektin e rivlerësimit; (ii) vërtetimin hipotekor, datë **.10.2000, për regjistrimin e objektit “****”, në emër të shoqërisë ndërtuese, si dhe (iii) kopje të aplikimit të kryer nga subjekti pranë ZVRPP-së, në datën **.4.2001, për regjistrimin e pasurisë në emër të tij dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

në këtë godinë një apartament banimi me sip. të përgjithshme 93,09 m², kundrejt çmimit 28.000 USD.

*Duke qenë se nga momenti i kryerjes së pagesave nga Blerësi, ka kaluar një kohë relativisht shumë e gjatë prej 22 vitesh, shoqëria “***” sh.p.k., në funksion edhe të ligjit për Kontabilitetin dhe Tatimet, nuk i kemi më të ruajtura këto dokumentet e asaj periudhe...*

*Kalimi i pronësisë dhe regjistrimi i pronës apartament me të dhënat sipas kontratës së shitjes, datë **.12.2000, është kryer pas përfundimit të procedurave të regjistrimit, fillimisht, në emër të shoqërisë në datën **.10.2000, e më pas në emër të subjektit përfitues [...].*

14.3 Komisioni, duke analizuar përmbajtjen e kontratës së shitjes, nga e cila rezulton se deri në datën e nënshkrimit të saj është likuiduar vlera 28.000 USD, si dhe dokumentacionin bankar, nga i cili vërtetohet se në datën **.2.2001, subjekti ka transferuar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., vlerën 8.000 USD, ka vlerësuar se duket se, në total, subjekti i rivlerësimit ka paguar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., vlerën 36.000 USD.

14.4 Komisioni ka konstatuar se kjo vlerë duket se përafrohet edhe me çmimin e referencës të përcaktuar në Udhëzimin nr. 5, datë 31.5.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe koeficientit “K” për vitin 2001¹², nga ku rezulton se vlera mesatare e shitblerjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2001, për qytetin e Tiranës, ka qenë 56.306 lekë/m² për sipërfaqe ndërtimi. Nga përlllogaritja e kryer nga Komisioni, bazuar në këtë udhëzim, rezulton se për një banesë me sipërfaqe 93,09 m² në qytetin e Tiranës, blerësi do të paguante mesatarisht vlerën 5.241.525,5 lekë (përafërsisht 36.000 USD).

14.4.1 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni në lidhje me çmimin e apartamentit, në përgjigje të pyetësorit datë 20.1.2023, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *çmimet e referencës të E.K.B. nuk kanë qenë detyruese për subjektet tregtare apo dhe për blerësit potencialë të këtyre pasurive... çmimi i shitjes është vendosur gjithmonë duke u mbështetur në raportin që vendosej njësi monetare, për çdo metër katrorë... e në përfundim vendosej edhe në marrëveshje me subjektet palë në kontratë si shitës-blerës. Pra, nuk është aplikuar çmimi i referencës, siç pretendohet më sipër. Dhe në rastin e shitblerjes së apartamentit, që aktualisht e kam në pronësi, pronari i subjektit tregtar e ndërtues ka caktuar si çmim bazë për metër katror atë të vlerës 300 dollarë [...]*¹³.

14.4.2 Komisioni ka hetuar në drejtim të vlerës së përcaktuar në kontratën e shitblerjes së apartamentit me sip. 93,09 m² të ndodhur në rr. “****”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, duke i drejtuar kërkesë¹⁴ ASHK-së, për paraqitjen e kontratave të ngjashme të shitblerjeve të pasurive “apartament” në të njëjtin objekt ndërtimi, ku ndodhet pasuria e subjektit të rivlerësimit. ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri¹⁵ ka vënë në dispozicion të Komisionit 5

¹² Në mungesë të evidencave nga EKB, për vitet 1999-2000, Komisioni ka marrë si referencë çmimet e përcaktuara nga EKB në vitin pasardhës nga kryerja e transaksionit.

¹³ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë kontratën e shitjes nr. ***/**, dt. **.12.2000, lidhur mes shoqërisë shitëse “****” sh.p.k. dhe blerësit ***.**. Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se blerësi ka përfituar apartamentin me sip.77m², për blerjen e të cilit ka paguar shumën 1.500.000 lekë.

¹⁴ Referohuni shkresës nr.*** prot., datë **.1.2023 dhe nr.*** prot. datë **.3.2023, drejtuar ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri.

¹⁵ Me shkresën “Kthim përgjigje” nr. *** prot. datë **.3.2023, Drejtoria Vendore Tirana Veri.

(pesë)¹⁶ kontrata të ngjashme të shitblerjes së apartamenteve, të gjendura në objektin *** kate në zonën e ***, regjistruar me nr. pasurie ***, ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., kontratat në të cilat ka rezultuar se çmimet e shitjes janë më të ulëta se vlera e shitblerjes e përcaktuar mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k.

14.5 Komisioni, referuar përmbajtjes së kontratës së shitjes, të nënshkruar nga subjekti dhe pala shitëse, ku deklarohet se çmimi 28.000 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale, ka vlerësuar, deri në këtë moment, se çmimi 28.000 USD do të konsiderohet i likuiduar deri në datën e nënshkrimit të kontratës, **12.2000, në përputhje me disponimin që vetë palët kanë bërë në përmbajtje të aktit të shitblerjes.

14.6 Në vijim Komisioni ka hetuar edhe në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese¹⁷. Nga informacioni i administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranë së cilës subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën në vitet 1998-2002, që përkon me periudhën e nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe likuidimin e çmimit të kësaj kontrate, nuk rezultojnë procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., administratorit të kësaj shoqërie në periudhën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, shtetasit ***.*** dhe bashkëshortes së tij, shtetases ***.***.

14.7 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁸, në përgjigjen e vënë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, ka informuar se subjekti ka hetuar procedimin penal nr. ***/2015, për veprën penale: “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve ***.*** dhe ***.***.

14.8 Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit ***.*** dhe dërgimin e çështjes penale në gjykim për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, në ngarkim të shtetasit ***.***.

14.9 Shtetasi ***.*** rezulton i emëruar në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., me vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë datë **.6.2021, me afat emërimi **.6.2021- **.6.2026. Ky shtetas ka firmosur në këtë cilësi në vërtetimet e lëshuara nga shoqëria “****” sh.p.k., drejtuar Komisionit dhe vetë subjektit të rivlerësimit, të sipërcituara.

14.10 Komisioni, lidhur me këtë situatë faktike, bazuar në datën e emërimit të shtetasit ***.***, në cilësinë e administratorit, ka konkluduar se procedimi i këtij shtetasi nga subjekti i rivlerësimit nuk është kryer në kushtet e konfliktit të interesit. Gjithsesi, procedimi penal, nr. ***/2015, është analizuar nga Komisioni dhe është pjesë e Raportit të aftësive profesionale,

¹⁶ (1) Kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.12.2000, me palë blerëse *** ***, me objekt shitblerjen e apartamentit me sip. 119 m² për çmimin 1.800.000 lekë; (2) Kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.12.2000, me palë blerëse ***.***, me objekt shitblerjen e apartamentit me sip. 93m² për çmimin 1.400.000 lekë; (3) Kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.12.2000, me palë blerëse ***.***, me objekt shitblerjen e apartamentit me sip. 93m² për çmimin 2.000.000 lekë; (4) Kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.12.2000, me palë blerëse ***.***, me objekt shitblerjen e pasurisë “dyqan”, në katin përdhe, me sip. 63,27 m² për çmimin 1.400.000 lekë; (5) Kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.12.2000, me palë blerëse ***.***, me objekt shitblerje tarrace ap.106 m² sipërfaqe e shfrytëzueshme 134 m², pra sipërfaqe e përgjithshme 240 m², për çmimin 2.000.000 lekë.

¹⁷ Referohuni shkresës nr.*** prot., datë **.1.2023, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë **.1.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁸ Referohuni shkresës nr. *** prot., datë **.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të paraqitur nga subjekti, në përgjigje të Pyetësorit datë 31.10.2022.

hartuar nga KLP-ja, si një nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, konkretisht dosja nr. ***, e këtij raporti.

14.10.1 Nga aktet nuk duket se Komisioni ka konstatuar problematika në analizimin e këtij procedimi. Gjithsesi, subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin plotësues nr. **, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **.2.2023, ka dhënë shpjegime mbi veprimet hetimore të kryera në lidhje me këtë procedim. Nuk duket që rasti të jetë trajtuar apo referuar më tej në vendimin e Komisionit nr. 671/2023.

14.10.2 Në përfundim, lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë *apartament* me sip. 93,09 m², Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi duket se për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka paguar vlerën 28.000 USD, të likuiduar deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, si dhe vlerën 8.000 USD, të transferuar nëpërmjet bankës në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k., në datën **.2.2001, në total në shumën 36.000 USD, shumë të cilën Komisioni e ka përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën deri në vitin 2001¹⁹.

14.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka prapësuar se: *[...] apartamenti është blerë në vitin 2000 dhe jo në vitin 2001. Paga për këstin e fundit, që ka shërbyer për blerjen e tij, është bërë në shkurt të vitit 2001 dhe në rrugë bankare. Duke mbajtur parasysh vitin e blerjes së tij, nuk ka pasur akte që të pasqyronin çmime reference, detyruese për palët e përfshira në një veprim juridik shitblerjeje, të cilave t’u referoheshin... Në rastin e shitblerjes së këtij apartamenti, pronari i subjektit ndërtues e tregtar ka caktuar si çmim bazë për metër katror atë në vlerën 300 USD. Në përfundim të marrëveshjes mbi çmimin e vendosur është bërë edhe pagesa e plotë për njësinë e banimit me dy këste, njëri prej të cilëve në vlerën cash dhe tjetri nëpërmjet rrugës bankare [...].*

14.12 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe pretendimet e tij, vlerësoi se: *[...] ato duhet të merren në konsideratë, në tërësi me: (i) deklaratat e subjektit në deklaratat periodike, të cilat, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë për këtë proces; (ii) veprimet e subjektit për likuidimin e kësaj pasurie, si dhe me (iii) kontratat e ngjashme të lidhura nga shoqëria me blerës të tjerë. ... Subjekti ka qenë konsistent në deklaratat e tij në deklaratat periodike, në Deklaratën “Vetting”, por edhe gjatë hetimit administrativ, ku ai ka deklaruar si çmim blerjeje për këtë apartament shumën 28.000 USD. Ai ka kryer të gjitha përpjekjet për të provuar këtë pagesë, duke depozituar edhe vërtetimin nr. *** prot., datë **.11.2022, të shoqërisë “***.***” sh.p.k., në përmbajtje të të cilit shoqëria deklaroi se blerësi i apartamentit ka paguar vlerën totale 28.000 USD, nga të cilat 20.000 USD janë paguar nëpërmjet arkës së shoqërisë dhe pjesa tjetër, prej 8.000 USD, është paguar me bankë [...].*

14.13 Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së dhe në drejtim të vlerësimit të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të subjektit me provat e administruara, ku: (1) sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë të lidhur mes palëve, më datë **.12.2000, referohet se çmimi është shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale, si dhe (2) të dhënat

¹⁹ Në këtë logjikë, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke konsideruar si shpenzim për blerjen e pasurisë në vitin 2000 shumën 28.000 USD dhe për vitin 2001 shumën 8.000 USD, i ka rezultuar pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për pagesën e vlerës prej 28.000 USD, në vitin 2000, në shumën – 1.665.100,80. Për më tepër referohuni Rezultateve të hetimit administrativ.

bankare dëshmojnë se edhe një vlerë prej 8.000 USD ka kaluar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., më datë **.2.2001, shtron si shkak ankimi faktin që duket se vlera e paguar për blerjen e pasurisë *apartament* me sipërfaqe 93,09 m², është 36.000 USD, dhe jo 28.000 USD.

14.14 Përgjigjet e subjektit në pyetësonin e datës 31.10.2022, si dhe vërtetimi nr. **, datë **.11.2022, bashkëlidhur këtij pyetësoni, i lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me kërkesë të subjektit, nënshkruar nga administratori ***.***, për të cilin duket se subjekti në procedimin penal nr. ***/2015 ka pushuar hetimet në ngarkim të tij, nuk duket se janë akte që krijojnë bindjen për të arritur në nivelin e provueshmërisë, lidhur me vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie.

14.15 Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit, si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit, edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me kuadrin ligjor të zbatueshëm, vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, duhen rivlerësuar nga Kolegji në drejtim të arritjes së konkluzionit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie.

14.16 *Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, atë të deklaruar kredi në formën e borxhit nga të afërm dhe miqtë.* Subjekti i rivlerësimit, për pasurinë *apartament* me sip. 93,09 m², në Deklaratën “*Vetting*”, ka deklaruar si burim të ardhurash për krijimin e tij, ndër të tjera, dhe 10.000 dollarë, marrë kredi në formën e borxhit, nga të afërmit dhe miqtë.

14.17 Në DV-2003, subjekti i rivlerësimit, në burimet e krijimit të kësaj pasurie, ka deklaruar (1) 2.000 USD (dollarë amerikanë) ***.***, vëllai; (2) 2.000 USD (dollarë amerikanë) ***.***, djali i xhaxhait; (3) 1.500 USD (dollarë amerikanë) ***.***, Tiranë; (4) 1.500 USD (dollarë amerikanë) ***.***, Vlorë.

14.18 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore të viteve në vijim, shlyerjen e këtyre huave dhe/ose vlerat e mbetura të detyrimeve financiare.

14.19 Në përgjigje të Pyetësonit Standard, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **.9.2020, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar huamarrje në vlerën totale prej 7.000 USD, nga shtetasit ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***. Në lidhje me kthimin e këtyre huave, subjekti ka deklaruar se huaja e marrë nga shtetasi ***.*** është shlyer pjesë-pjesë dhe tërësisht, deri në vitin 2007, huaja e marrë nga shtetasi ***.*** është shlyer tërësisht në fund të vitit 2004, huaja e marrë nga shtetasi ***.*** është shlyer tërësisht pas vitit 2004 dhe huaja e marrë nga shtetasi ***.*** është shlyer pjesë-pjesë deri në vitin 2007.

14.20 Komisioni, në pyetësonin e datës 31.10.2022, e pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me arsyen e deklarimeve kontradiktore të burimit të krijimit të kësaj pasurie, në Deklaratën “*Vetting*”, DV-2003, si dhe në pyetësonin standard, mbi mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, të shlyerjeve të huave ndaj huadhënësve respektivë, duke i kërkuar të saktësojë periudhat (muajin, vitin) dhe vlerën përkatëse të shlyerjes së secilës hua në favor të huadhënësve, shoqëruar dhe me dokumentacionin provues.

14.21 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e tij, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *mund të them se Deklarata “Vetting” duhet të jetë printuar pa u verifikuar. Paraprakisht është*

formular një koncept paraprak i saj dhe pasqyruar thjesht vlerat si ndarje strukturale, për pasurinë monetare timen e të tjerëve, e marrë hua apo edhe të huas së bankës, e ky koncept ka mbetur i paverifikuar përfundimisht, për t'u saktësuar para printimit të deklaratës. Theksoj se kjo gjë ka ndodhur për shkak të pakujdesisë e mungesës së verifikimit përfundimtar të të dhënave të deklaratës Vetting... Për sa i përket faktit pse nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore shlyerja ndaj huadhënësve e vlerës së huas, që në terma ekzaktë kapin vlerën 7.000 dollarë, deklaroj se një gjë e tillë nuk është bërë me shlyerje të menjëhershme të secilës shumë të huas, e për më tepër nuk ka ndodhur në një moment të caktuar. Në pjesën më të madhe të rasteve, shumat e huas nuk janë shlyer tërësisht, por pjesë-pjesë dhe shuma për secilën shlyerje ka qenë nën vlerën 300.000 lekë [...].

14.22 Komisioni, pasi ka administruar përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar se ky i fundit duhet të kishte treguar kujdesin e nevojshëm që të plotësonte saktë Deklaratën “Vetting”, sikundër kërkohet nga ligji nr. 84/2016, dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi duket se deklaratimet e subjektit në Deklaratën “Vetting”, në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit, nuk përputhen me deklaratimet e tij në DV-2003, pyetësorin standard, si dhe gjatë hetimit administrativ.

14.22.1 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mbi mosdeklarimin e shlyerjes së huave apo detyrimit financiar të pashlyer ndaj personave të tretë, Komisioni ka konstatuar se qëndrimi i subjektit nuk është në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar²⁰. Në pikën “Dh” të nenit 4 të këtij ligji përcaktohet se objekt deklarimi nga subjektet e ligjit janë, ndër të tjera: “...detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”, pa përcaktuar kufirin e vlerës minimale të detyrimit.

14.22.2 Gjithashtu, i njëjti përcaktim gjendet dhe në seksionin: “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, të deklaratave vjetore të ILDKPKI-së, ku sqarohet se në detyrimet financiare të deklarueshme do të përfshihen të gjitha detyrimet (kredi, hua, borxh etj.), që kanë shërbyer për të krijuar pasuri të ndryshme, duke përfshirë deklarimin mbi shumën e detyrimit financiar të shlyer deri në datë 31 dhjetor të vitit përkatës, si dhe detyrimin e pashlyer të këtij viti, pavarësisht vlerës së detyrimit. Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime bindëse për këtë rezultat.

14.23 Komisioni, pavarësisht sa më sipër, ka marrë për bazë deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ për sa i përket burimeve që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie dhe ka hetuar në lidhje me burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe mundësinë e personave të tjerë të lidhur, për t'i dhënë subjektit huat e deklaruara, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka konstatuar se:

*[...] Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion, të ardhurat e ligjshme të huadhënësit ***,***, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 2.000 USD në vitin 2000. Komisioni nuk e ka konsideruar huamarrjen nga shtetasi ***,*** si burim për blerjen e pasurisë apartament.*

²⁰ “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.”

(2) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion, të ardhurat e ligjshme të huadhënësit ***.*** nga puna si avokat, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 1.500 USD në vitin 2000, sipas deklaramit të subjektit. Komisioni nuk e ka konsideruar huamarrjen nga shtetasi ***.*** si burim për blerjen e pasurisë apartament.*

(3) *Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në vlerën 1.665.100,80²¹ lekë, për pagesën e shumës 28.000 USD, në datën e nënshkrimit të kontratës [...].*

14.24 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, lidhur me deklaramin e huave dhe shlyerjen e tyre, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit. Për sa i përket burimeve të ligjshme të dy prej huadhënësve, për të cilët Komisioni ka konstatuar pamjaftueshmëri financiare (***.*** dhe ***.***), për shtetasin ***.***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka pasur burime në dispozicion nga aktiviteti i ushtruar i palicencuar, duke vënë në dispozicion dhe konfirmimin nga *** Bank mbi disa depozitime të hershme të këtij shtetasi. Për huadhënësin ***.***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka burime të ligjshme të ardhura nga aktiviteti privat dhe ka vënë në dispozicion aktin: *Fletë Njoftimi Tatimi*, të vitit 2000, që referon xhiro deri në 2.000.000 lekë për tatim paguesin ***.***.

14.25 Komisioni, pasi ka analizuar shpjegimet e subjektit dhe aktet bashkëlidhur, ka arritur në konkluzionin se: *[...] Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit ***.***, për rrjedhojë huaja në shumën 2.000 USD nuk do të përfshihet në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti... subjekti i rivlerësimit mundi të provojë se huadhënësi ***.*** ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas, vendosi ta përfshijë këtë hua në analizën financiare për blerjen e pasurisë apartament [...].*

14.25.1 Lidhur me mosdeklaramin e shlyerjes së huave, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e nevojshëm për deklaramin e detyrimeve financiare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. Në kushtet kur këto pasaktësi rezultojnë në deklaratat periodike, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²², ato nuk mund të shërbejnë si indikatorë për procesin e rivlerësimit të subjektit²³.

14.25.2 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisionit, në konsideratë të pretendimit të subjektit mbi çmimin e blerjes së apartamentit në shumën 28.000 USD, paguar 20.000 USD në vitin 2000 dhe 8.000 USD në vitin 2001, si dhe përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të huas nga shtetasi ***.***, i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shumën -133.220,34 lekë, për pagesën e këstit prej 20.000 USD, të çmimit të apartamentit në vitin 2000. Kjo pamjaftueshmëri është konsideruar se nuk përbën shkak që deklarimi i subjektit të konsiderohet i pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

²¹ Referuar analizës të Komisionit në konsideratë të vlerës së blerjes së pasurisë prej 36.000 USD.

²² Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë **6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë **7.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë **11.2020, të Kolegjit.

²³ Gjithsesi, Komisioni ka përfshirë në analizë financiare kthimin pjesor të huas ndaj shtetasit ***.***, në periudhën prill 2002 – 2007 dhe kthimin pjesor të huas ndaj shtetasit ***.***, në periudhën 2004 – 2007, sipas deklaramive të subjektit gjatë hetimit administrativ, analizë nga e cila ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e huave ndaj huadhënësve ***.*** dhe ***.***.

14.25.3 Komisioni ka kryer edhe një analizë hipotetike, duke e konsideruar çmimin e blerjes së këtij apartamenti në shumën 36.000 USD, duke i rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme blerjen e këtij apartamenti në shumën - 1.274.340.34 lekë. Për këtë pamjaftueshmëri, Komisioni ka arsyetuar se, edhe sikur për një moment të merret si vlerë e apartamentit shuma 36.000 USD, mungesa e mjeteve financiare është e tillë që, bazuar në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në raste të ngjashme, nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra²⁴.

14.26 *Komisioneri Publik*, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së dhe në analizë të akteve të administruara në funksion të hetimit administrativ, vlerëson se, përveç mospërputhjeve të deklarimeve mbi shumat e huave nga individët e mësipërm në deklaratën e vitit 2003 dhe atë “Vetting”, mbetet i provuar dhe mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, i ecurisë së marrëdhënies së huave dhe shlyerjeve të tyre. Këto marrëdhënie interesi të krijuara mes palëve, duhet të ishin deklaruar rregullisht që nga momenti i krijimit dhe deri në shuarjen e tyre, në deklaratimet periodike të subjektit pranë ILDKPKI-së.

14.27 Në këto rrethana, *Komisioneri Publik* vlerëson se: (1) deklaratimet kontradiktore lidhur me shumat e marra hua; (2) mosdeklarimet nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të shlyerjes së tyre, si dhe (3) mungesa e provueshmërisë me dokumentacion provues lidhur me marrjen, kthimin dhe, më së paku, në një rast i mundësisë financiare të huadhënësit për të mundësuar dhënien e huas, janë rrethana që duket se duhen të analizohen dhe rivlerësohen nga Kolegji, në kuptim të efekteve juridike në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016.

14.28 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, në gjendjen që janë aktet në dosje, është i nevojshëm rivlerësimi nga Kolegji i zërave të analizës financiare lidhur me vlerën reale të blerjes së pasurisë dhe burimeve të ligjshme të deklaruara nga subjekti si burim krijimi për këtë pasuri, kryesisht huat nga personat e tjerë të lidhur dhe mundësisë financiare të tyre për të dhënë huat e deklaruara.

14.29 Gjithashtu, në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, Komisioneri Publik arsyeton se proporcionaliteti vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision apo atij në Kolegji. Negativiteti i konstatuar në rastin konkret, lidhet me një pasuri të vetme në momentin e blerjes së saj dhe nuk shtrihet në vite dhe, si i tillë, ka nevojë t’i nënshtrohet juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, në drejtim të përcaktimit të saktë të nivelit të ligjshmërisë së burimeve të subjektit të rivlerësimit dhe pasojën që sjell në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

²⁴ Komisioni ka referuar dhe paragrafin 96 të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), **. vs Albania, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, Komisioni vlerëson se kjo shumë nuk klasifikohet si deklarim i pamjaftueshëm për të shërbyer si shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra.

15. Lidhur me shkollimin e vajzës së subjektit, znj. *.***, në Itali, për periudhën tetor 2013- prill 2014**

15.1 Në DV-2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shpenzime për studimet e vajzës në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e *** - Itali*. Po në të njëjtën deklaratë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *pakësim në vlerën 1.400.000 lekë nga banka *** dhe *** nga të ardhurat nga pagat*, ndërsa në seksionin e të dhënave konfidenciale, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *shpenzime për studime të vajzës në shumën 1.400.000 lekë, banesë, ushqim*.

15.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nëse ka pasur ndonjëherë shpenzim më të madh se vlera 2.500 euro, në përgjigje të pyetësorit standard, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *që nga momenti i marrjes së detyrës, kam realizuar shpenzime më të larta se 2500 euro që prej vitit 2013. Në këtë vit ka filluar studimet në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i ***, vajza ime, ***.***, e cila ka qëndruar aty nga muaji tetor 2013 deri në muajin prill 2014, periudhë pas të cilës ajo është kthyer në Shqipëri për të vazhduar studimet e mëtejshme në Universitetin “Zonja e Këshillit të Mirë”, Tiranë. Gjatë periudhës së qëndrimit të saj në Itali është paguar shuma prej 800 euro, si pagesë vjetore studimi. Vajza ka përdorur për banim një apartament të marrë me qira në *** “****” nr.***. Për të është paguar qira mujore prej 340 euro, e cila për periudhën 7- mujore të qëndrimit të saj kap shumën prej 2.380 euro, pa përfshirë shpenzimet për ushqim, konsum të ujit, energjisë elektrike, e ato që quhen shpenzime kondominiale, që arrijnë në shumën 250 euro në muaj. Për këtë periudhë, shpenzimet në total kapin shumën rreth 1750 euro... Shpenzimet e realizuara për arsimimin e fëmijëve janë paguar nga depozitat e kursimeve të krijuara ndër vite dhe e kanë pasur burimin nga pagat e mia dhe të bashkëshortes [...].*

15.3 Komisioni, në verifikim të deklaratave periodike vjetore, dhe të llogarive bankare ku ka konstatuar tërheqjen e shumës totale 1.400.000 lekë, ndër të tjera, i ka kërkuar subjektit, në pyetësorin e datës 31.10.2022, të informojë Komisionin nëse vajza e tij ka çelur llogari bankare në Itali dhe nëse po, të vërë në dispozicion të hetimit nxjerrjen e kësaj llogarie.

15.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Nuk mund të jap përgjigje nëse vajza ime ka çelur llogari bankare në *** Itali, por di të sqaroj se, pagesat e mia për shpenzimet e kryera nga vajza, gjatë periudhës që ajo ka qenë në Itali për studime e për jetese, i janë dhënë posaçërisht prej meje në formën e pagesës cash. Nëse ajo ka hapur llogari bankare, kjo gjë është bërë vetëm që ajo të realizojë ndërmjetësimin e bankës, për të kryer pagesat e nevojshme në institucionet përkatëse [...], duke bashkëlidhur dhe dokumentacion justifikues²⁵. Komisioni ka arsyetuar se ky dokument i paraqitur nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për të evidentuar llogarinë bankare të vajzës së subjektit, ***.***, dhe lëvizjet e kryera në këtë llogari.*

15.5 Në vijim, Komisioni në rezultatet e hetimit, ka arsyetuar se, pavarësisht kërkesës së Komisionit për të depozituar dokumentacion bankar, si dhe vënies në dukje të faktit që mos dorëzimi i dokumentacionit do të konsiderohet si mungesë bashkëpunimi, subjekti, sërish, ka

²⁵ Subjekti, ndër të tjera, ka paraqitur dokument nga *** Bank Itali, për pajisjen e shtetases ***.*** me kartën bankare, i cili nuk përmban emërtim, datë dhe të dhëna mbi llogarinë bankare të ***.*** pranë kësaj banke, si dhe fotografim nga aparat celular lidhur me njoftimet e mbërritura në rrugë elektronike për kalimin e pagës mujore.

refuzuar të depozitojë nxjerrjet e llogarive të vajzës së tij në Itali për periudhën e rivlerësimit dhe në vijim. Për sa më sipër duket se subjekti, me mosveprimet e tij, reflekton mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

15.6 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë konstatim, në parashtrimet e tij²⁶, ka pretenduar: *se të gjitha pagesat për shpenzimet e kryera nga vajza e tij gjatë periudhës që ajo ka qenë në Itali, shpenzime që kanë mbuluar studimet dhe jetesën e saj, i janë dhënë posaçërisht prej tij në formën e pagesës cash... Depozita e vajzës së tij në *** Bank ka shërbyer si garanci për marrjen e vizës nga ana e saj për të ndjekur studimet në shtetin italian. Në këtë llogari janë kryer veprimet si vijon: në datën *.11.2013 tërhiqet shuma 1.762,55 euro dhe në datën *.1.2014 shuma 3.999 euro. Kjo është pikërisht periudha që përkon me qëndrimin e vajzës së tij në Itali... Janë këto shuma parash që i janë vënë në dispozicion vajzës për të vazhduar studimet në Itali, për një periudhë relativisht të shkurtër, të cilat i ka pasqyruar edhe më herët. Nëpërmjet këtyre të dhënave, duket qartë se kush ka qenë burimi i financimit për periudhën e qëndrimit të vajzës në Itali dhe vlera e tyre. Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të tij nxjerrjen e llogarisë bankare të vajzës, ***,***, në *** Itali, për vitet 2021 – 2022.*

15.7 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, duke konsideruar faktin se shkollimi i vajzës së tij në shtetin italian ka zgjatur vetëm për 1 semestër shkollor dhe shpenzimet e kryera për këtë shkollim janë deklaruar saktësisht nga subjekti, si dhe janë provuar me dokumentacion provues, ka arsyetuar se i vlerëson bindëse shpjegimet e tij në lidhje me këtë konstatim. Komisioni verifikoi edhe nxjerrjet e llogarisë bankare të vajzës së subjektit në *** Bank për periudhën 2021 – 2022 dhe konkludoi se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me lëvizjet bankare të vajzës së tij.

15.8 *Komisioneri Publik*, bazuar në Rekomandimin e ONM-së dhe në analizë të akteve të administruara, konstaton se dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, nuk është në formën e caktuar ligjore, që të konsiderohet me vlerë provuese gjatë gjykimit për efekt të procesit të rivlerësimit, për të krijuar bindjen se në llogarinë e vajzës së subjektit të rivlerësimit ka kaluar vetëm bursa e shkollës dhe jo transferta të tjera.

16. Si përfundim, Komisioneri Publik, në të tilla rrethana, brenda kompetencave të tij kushtetuese, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se shkaqet e ankimit në vlerësimin e kriterit të pasurisë do të duhet të gjejnë përgjigje gjatë vlerësimit të çështjes në Kolegj, si organ rivlerësimi që Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

V. Kërkimi i ankimit

17. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruar në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

²⁶ Për më shumë, referohuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

18. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

19. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

20. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi për ushtrim ankimi i një Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, nr. 411/1 prot., datë 30.6.2023.

1. Introduction

Mr. Ylli BASHAJ has been assessed by the Independent Qualification Commission (hereinafter "IQC") pursuant to Article 179/b, par. 3 of the Constitution and in accordance with the provisions of the Vetting Law. The IQC decided to confirm the assessee in duty.

The International Observers (further: IOs or IMO) recommend the Public Commissioners to file an appeal against the whole results of the assets assessment.

IMO's views are that a proper investigation and analysis of the gathered elements and a proper evaluation of evidence would probably guide the Vetting Bodies towards a decision leading to the dismissal of the assessee.

2. Grounds of the recommendation and their analysis

For the assets assessment

IMO challenges the conclusions of the panel regarding the whole assets assessment and, in particular, those outlined as below.

1) With regards to the apartment of 93.09 m2

The IQC decision which confirmed the assessee in office is elaborated under the assumption that the price for the apartment of 93.09 m2 was 28.000 USD. However, this merely an assumption had to be assessed more carefully and should not have been taken as an assumption for the underlying IQC reasoning and conclusions.

The International Observer would like to point out some issues regarding the loan of USD 8.000 from Italian-Albanian Bank (currently *** ** Bank) on **.02.2001.

In his explanations to the results of investigations, the assessee has been persistent in stating that he has paid – for the apartment of 93.09 m2 - only USD 28.000 to the company in two trenches: the 1st trench of USD 20.000 was allegedly paid in the company's cash box, whereas the 2nd trench of USD 8.000 was allegedly paid through the bank loan.

This International Observer is of the opinion that to determine whether the loan of USD 8.000 should be included or not in the financial analysis as a source - and/or if only USD 28.000 were paid for the apartment and not USD 36.000 - the following evidentiary elements should be considered, as they look quite contradictory, and the information contained in them is not consistent to each other.

- a) **1ST DECLARATION OF THE ASSESSEE in 2004**, where the assessee reported the following:

Description	Surface	Price	Source
<i>Apartment</i>	93 sqm	USD 28.000	USD 13.000 – SAVINGS
			USD 2.000 – *** *** (brother)
			USD 2.000- *** *** (cousin)
			USD 1.500 – *** ***
			USD 1.500- *** ***
			USD 10.000 – LOAN FROM BANK IN 2001

- b) **VETTING DECLARATION**,¹ where the assessee reported as follows:

Description	Surface	Price	Source
<i>Apartment</i>	93 sqm	USD 28.000	USD 10.000 – SAVINGS
			USD 10.000 – IN THE FORM OF DEBT BORROWED FROM RELATIVES AND FRIENDS
			USD 10.000 – LOAN FROM BANK IN 2001

¹ The assessee has “reviewed” what he declared in the Standard Questionnaire, claiming that he had submitted the Vetting Declaration without checking it properly after printing it out! He has stated that the loan amount of USD 10.000 was composed of the main amount of USD 8.000 and that the remaining part were the interest to be paid

- e) **SALE CONTRACT NO.*** REP., *** KOL., DATED ** .12.2000** mentions that the price for the apartment of 93.09 m2, in the amount of USD 28.000, was paid completely outside the notary office;
- d) **LOAN CONTRACT NO.*** REP.,*** KOL., DATE ** .02.2001:** the documents related to the loan of USD 8.000 for the purchase of the apartment reports that the said apartment was offered to be mortgaged in for the loan;
- e) **REPLY FROM *** *** SHPK TO IQC:** The company, in its reply, has stated that the apartment of 93.09 m2 was purchased for USD 28.000. Due to the long time that passed, the only documents that could be obtained were the sale contract No.*** REP.,*** KOL., DATE **** .12.2000, and the certificate of ownership under the name of the construction company, in which it is reported that “[...] The transfer of ownership title and the registration as per sale contract no. *** REP., *** KOL., DATE ** .12.2000 was performed after the fulfillment of the registration initially under the ownership of *** *** Shpk on ** .11.2000 [...]”;**
- f) **REPLY FROM *** *** SHPK TO ASSESSEE:** In the replies to the questionnaire dated 31.10.2022, confirmation/certificate Prot. no. **, dated ** .11.2022 of the company “ *** *** ” sh.p.k. - which was issued in response to the assessee’s request, the company (unlike the information sent to the IQC – where the terms of the contracts are referred) stated that the buyer of the apartment paid in favor of the company the total amount of USD 28.000, of which USD 20.000 were paid to the company’s finance office while the remaining USD 8.000 were settled through the bank;
- g) **BANK STATEMENT ATTACHED TO THE CERTIFICATE FROM *** *** *** BANK (FORMER ITALIAN-ALBANIAN BANK) dated ** .09.2020:** The bank statement provides evidence that the amount of USD 8.000 were disbursed and, then, transferred to the construction company’s account within the same day, meaning ** .02.2001; however this date is almost two months later than the information reported in the sale contract (which reports the settlement of USD 28.000).

Considering the above, the International Observer is of the opinion with regards to the price of the apartment **the evidence is very contradictory. Nevertheless, having in mind the content of the sale contract (stating that the price was paid completely outside the notary office) and the bank statements (testifying the disburse of 8.000 USD), this International Observer believes that the real price that should be considered for the apartment is USD 36.000 and NOT USD 28.000.**

The replies to the questionnaire dated 31.10.2022 and the feedback provided to the assessee by *** *** SHPK cannot be considered as reliable evidence. It is important to note that the confirmation/certificate Prot. no. **, dated ** .11.2022 of the company “*** *** ” sh.p.k. is signed by the administrator of the company whose name is

*** ***

Worth of note, it appears that the assessee dismissed some charges against *** ** in 2015. Case file No. *, related to the criminal proceeding no. ***/2015 of the Prosecutor's Office at the Court of First Instance in Tirana (registered for the criminal offense "Production and sale of narcotics", provided for in article 283/1 of the Criminal Code of the Republic of Albania), was referred by the IQC in the results of investigation but not referred – nor properly recalled - in the IQC decision.² In light of the above, *** 's information cannot be considered as reliable, above all considering the fact that their content contradict the content of the information/replies previously provided to the IQC.

Therefore, the International Observer opines that the assessee has paid the sum of 28.000 USD to the company outside the notary office (as stated in the contract) AND also the 8.000 USD received as a loan. It was indeed not rare, in Albania, that the declared value in the contract of sale of a real estate is lower than the real value agreed between the parties, and that the buyer gets financed from the bank of a part of the price declared in the contract which is not, however, the total price paid to (and agreed with) the construction company, often through resorting to cash money.³

Considering the above, the fact that the IQC concluded in the sense that the total price of the apartment was 28.000 USD, out of which 8.000 settled through a loan, cannot be shared, as it is a conclusion which cannot be reached according to a proper evaluation of the available evidence.

2) *Regarding the loans/debts taken from relatives and friends*

The International Observer would like to point out that besides the content of the Vetting Declaration and of the Periodical Annual Declarations, there is no reliable documentary evidence that would support the existence of loans received by ' *** ** (USD 2.000), *** ** (USD 1.500) and . *** ** .

Besides that, it appears that the IQC is using as evidence for these loans the assumption that *** **, *** ** and *** ** had the financial capability to provide them. Nevertheless, it must be pointed out that the IQC investigation on the issue is not thorough, and it is rather insufficient and inaccurate. More specifically, it seems that the IQC has determined the financial capacities of the lenders by deducting only living costs from their incomes. IQC has neither enquired nor investigated if the lenders had children, if they purchased real estate or made other investments, nor did they check whether they had other financial obligations or expenses for their families. In such a situation, it is difficult – if not impossible – to logically share the IQC conclusions in terms of congruency of the financial capability of the lenders for the loans which were provided to the assessee, irrespective of the numerical amount.

² IQC made also reference, in point 1.15 of the results of investigations sent to the assessee, of this case, in the part where they were investigating the existence of a conflict of interest.

³ It cannot be excluded that, to facilitate the registration of the apartment as collateral, the sale contract had to be registered in the cadaster office prior to the real payment. Therefore, it could also be possible that the sale contract for the payment - signed in December 2000 - might be fictitious.

The the non-declaration of the eventual debt repayments (had the loans been granted to the assessee, or had there been a financial capability of the lenders - which things are, as said doubtful) is an additional inaccuracy, despite of the assessee's explanations.⁴

3) Studies of assessee's daughter in Italy:

It must be noted that the bank statements provided by assessee from [*** *** ***] Italy are not in the form prescribed by the law to be admitted and considered as reliable evidence in this proceeding (not legalization with, e.g., apostille stamp)⁵; hence, the content of the said bank statements (from which it could be ascertained that the scholarship was paid in the assessee's daughter account with no other evidence for any deposit of transfer from anyone else) cannot be considered by the IQC.

Considering the above, this International Observer believes that the IQC should have been more careful in assessing the evidence at its disposal and that a different result in the assets assessment should have been reached for the assessee.

3. Conclusions

The confirmation of the assessee in office is the result of an incoherent and incomplete investigation carried out by the IQC on the assets assessment and by an evaluation of evidence that goes against the principles expressed by the Vetting Law in its Art. 49(4). The evidence used by

⁴ With regards to the accuracy of the Vetting Declaration, the mental element is not relevant. The IQC seems to condone the assessee for his negligence in drafting the Vetting Declaration, but it is important to remind, on the point, the relevant AC jurisprudence in AC decision 1/2021 ([*** ***]) where the AC stated that:

"24.1 [...] the constitutional and legal provisions that govern the responsibility for accurate disclosure do not stipulate that the sufficiency and accuracy must analyze the assessee's intentions/goals. Specifically, Article D, paragraph 5 conditions the presumption in favour of the disciplinary dismissal sanction and the obligation on the assessee to prove the contrary through attempts to *inaccurately represent the assets in ownership, possession or use* [...]"

⁵ See the principle expressed in AC Decision 13/2019 in the case of [*** ***] , where the AC stated that:

"62. The assessee attached to his explanations on the results of the administrative investigation an affidavit [...]. The affidavit of Mrs. *. *. * is not legalized by apostil, therefore - taking into account the fact that as a judge the assessee is aware of the formal criteria that an act/document drawn up in a foreign country must meet to be used as evidence in a court of Albania, as well as referring to case-law of the Chamber - the Trial Panel does not give it any probatory value in this judgment."

And also the principle expressed in AC Decision 25/2019 in the case of [*** ***] , where the AC stated that:

"25.2 [...]"

As for the income from his mother pension in Italy, the documents administered in the case file indicate that a number of documents in Italian were submitted to support such income; they were not translated, not notarized and do not contain an apostille stamp. In this context, since the assessee failed to submit documents, which comply with the requirements of Article 266 of the Code of Civil Procedure, proving the financial ability of his mother to provide the donations in question with income from lawful sources, the Trial Panel concluded that such source should not be considered as lawful one justifying the donations over the years."

the IQC for its conclusions and decision is far from being reliable or strongly consistent with the other evidence gathered during this re-evaluation process.

IMO deems that a proper investigation and a proper evaluation of the information and documentation eventually gathered, together with the evidence already at disposal of the panel, would have probably led the vetting bodies to the conclusions that the assessee lacks lawful sources to justify at least part of his assets.

Hence, the IQC should have reached a different conclusion in line with what has been presented in this Recommendation. The IQC decision is therefore incorrect, as incorrect is its evaluation of evidence - which was also negatively affected by the lack of a proper investigation on all relevant elements to assess the financial capabilities of the other related persons.

Hence, a Recommendation to appeal the IQC decision on the whole assets assessment that confirmed Ylli Bashaj in office is hereby filed, and the Public Commissioner is left with the discretion to include additional grounds to his appeal.

Respectfully submitted,



International Observer

International Observer

International Observer